

U D H E Z I M
Nr. 31 Dt.

Sot ne dt.06.04.1999, unë Arben Rakipi, Prokuror i Përgjithshëm, me qellim për te krijuar praktike te njëjte ne paraqitjen ne gjykimin e ceshtjeve, me qellim për te lehtësuar paraqitjen ne gjykim te ceshtjeve ne Gjykatat e Apelit apo ne Gjykatën e Larte me qëllimin qe provat e marra ne hetimet paraprake te mund te vlerësohen me mire gjate gjykimeve ne shkalle te ndryshme gjyqësore, bazuar ne nenin 24 te Kodit te Procedurës Penale

UDHËZIJ:

1. Gjate gjykimit ne shkalle te pare te bëhen përpjekje me te mëdha për te vlerësuar dhe interpretuar provat e marra ne hetimet paraprake. Jo rralle vihen re tendenca te prokuroreve, gjate gjykimeve, për te injoruar cfare ata apo oficeret e policisë gjyqësore kane grumbulluar ne hetimet paraprake, duke keqinterpretuar ligjin procedural penal, Këto qëndrime qe vijnë ose nga moskuptimi i thelbit te ligjes apo nga motive neglizhence dhe mospergjegjesi ndaj punës, kane çuar jo rralle ne situata absurde te tërheqjes se akuzave te ngritura. Këto te fundit janë formuluar nga vete prokuroret ne baze te hetimeve te kryera dhe provave te marra gjate hetimeve paraprake.

Duhet kuptuar ne thelb ligja procedurale penale lidhur me rolin e oficerit te policisë gjyqësore. Te gjithëve duhet te na beje përshtypje fakti qe veprimet e para ne një ngjarje kriminale kryhen nga oficeret e policisë gjyqësore te komisariateve, si këqyrja e vendit te ngjarjes, vendimet për ekspertime te ndryshme, sekuestrimet, arrestimet ne flagrance, etj. Këto veprime qe përmenda merren si te mirëqena gjate gjykimit te ceshtjeve dhe, po te shkojmë me te njëjtën logjike, nuk ka pse thëniet e personave qe deklarojnë rrethana te ndryshme te mos merren ne konsiderate. Fakti qe ata janë pyetur nga oficeret te policisë givqesore është marre parasysh nga ligjvënësi ne formulim te ligjes.

Ne rastet kur thëniet e dëshmitareve gjate gjykimit nuk janë te njëjta me deklarimet e bëra gjate hetimeve paraprake, atëherë, jo vetëm ata duhet te ballafaqohen me cfare kane thëne gjate hetimit, por te japin edhe shkaqet pse kane ndryshuar thëniet. Pas kësaj është e domosdoshme për tu bere thërritja ne gjykim e oficerëve te policisë gjyqësore qe kane marre deklarimet me qellim jo vetëm te ballafaqohen me dëshmitaret, por edhe te shpjegojnë si i kane marre dëshmitë, a është shprehur ne to vullneti i

dëshmitareve apo jo, etj.

Kjo mase do të shërbejë jo vetëm për disiplinimin në thëniet e personave të pyetur, jo vetëm në disiplinimin në marrjen e thënies nga oficeret e policisë gjyqësore por edhe do të ndihmojë gjykatën për të dhënë drejtësi.

2. Në të gjitha rastet kur do të ketë kundërthëniet ndërmjet deklaratimit në hetimet paraprake dhe dëshmisë në gjykim, në përputhje me nenin 371 të Kodit të Procedurës Penale, është e domosdoshme që procesverbalet dhe aktet e lexuara të futen në fashikullin gjyqësor. Ky veprim do të ndihmonte prokurorët e Apelit për të hyre me mirë në përmbajtjen e dosjes gjyqësore.
3. Në të gjitha rastet esenciale të kundërthënies të fillojë procedimi penal për dëshmi të rreme duke kërkuar gjykim të drejtpërdrejtë për të pandehurit.
4. Ky udhëzim tu shpërndahet të gjithë prokurorëve të Prokurorisë së Përgjithshme, prokurorëve të Apeleve dhe të rretheve.

Pasi të punohet me gjithë prokurorët e rretheve dhe Apelit, Drejtoria e Hetimit dhe ajo e Kuadrit në Prokurorinë e Përgjithshme të mbledhin përgjigjet me shkrim nga rrethet dhe Apelet që udhëzimi u bë i njohur.

5. Një kopje e udhëzimit t'i dërgohet Ministrit të Brendshëm për t'ua bërë të njohur strukturave vartëse të tij.
6. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

PROKURORI I PËRGJITHSHEM
ARBEN RAKIPI



